

VENDIM
Nr. 497, datë 1.8.2012

**PËR MIRATIMIN E DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË
TË REGJIMIT KOMUNIST**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë dhe për familjarët e të dënuarve me dënim kapital, sipas listës së përfshirë në anekset “A”, “B” dhe “C”, që i bashkëlidhen këtij vendimi e janë pjesë përbërëse e tij.

2. Masa e dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë dhe familjarët e të dënuarve me dënim kapital/ekzekutim, pa gjyq, për motive politike, të bëhet me këste, sipas kriterëve e kufijve të përcaktuar në nenin 12 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar.

3. Shuma e llogaritur transferohet në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfitues bëhet nga Ministria e Financave, në llogaritë personale të këtyre përfituesve, të hapura në bankat e nivelit të dytë, të përzgjedhura sipas nenit 33 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2017, të ndryshuar.

4. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha